



INSTITUCIONI I OMBUDSPERSONIT në KOSOVË

RAPORTI I PARË VJETOR

2000 – 2001

adresuar

z. Hans Hakerup

**Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të
Kombëve të Bashkuara**

18 korrik 2001

Tel: ++381 38 548 087

e-mail: ombudspersonkosovo@hotmail.com

web site: www.ombudspersonkosovo.org

Përmbajtja

Hyrje	1
Prapavija dhe historia	1
Natyra e Institucionit	1
Procedurat para Ombudspersonit	2
Kërkesat për intervenime politike	3
Bashkëpunimi me institucionet e tjera ndërkombëtare evropiane	3
Lidhjet me media	5
Fondet	5
Problemet e ballafaquara	5
Prospektet në të ardhmën	6
<u>Aneksi 1</u>	8
Përmbledhja e çështjeve	8
<u>Aneksi 2</u>	15
Tekstet e letrave ku është kërkuar të ndërmerren veprime politike	15
<u>Aneksi 3</u>	19
Rregullorja mbi krijimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë	19
<u>Aneksi 4</u>	24
Rregullat Procedurale për Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë	24

RAPORTI VJETOR

Hyrje

Ky raport vjetor është lëshuar në pajtim me nenin 17.1 të Rregullorës 2000/38 të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) mbi krijimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë dhe rregullën 22.1 të Rregullave Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit.

Ky raport vjetor mbulon periudhën para hapjes formale të Institucionit me 21 nëntor 2000 dhe periudhën prej asaj date deri më 30 qershor 2001.

Prapavija dhe historia

Institucioni i Ombudspersonit në Kosovo është krijuar me Rregullorën e UNMIK-ut 2000/38 (30 qershor 2000) (Rregullorja) më qëllim të shtimit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Kosovë. Me 11 korrik 2000, me rekomandimin e Kryesuesit të Zyrës së Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në Austri, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (PSSP) emëroi Marek Antoni Nowicki si Ombudsperson. Me 15 shtator 2000, PSSP i emëroi tre zëvendësat në bazë të Rregullorës (Z. Nike Lumezi, Z. Ljubinko Todorovic dhe Znj. Donna Gomien).

Institucioni i Ombudspersonit formalisht është inaguruar me 21 nëntor 2000.

Si një Institucion i dedikuar për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, Institucioni i Ombudspersonit ka personelin lokal që është i përbërë prej përafërsisht 30% anëtarë të minoriteteve etnike.

Natyra e Institucionit

Institucioni i Ombudspersonit promovon dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve dhe entiteteve ligjore dhe ndihmon të sigurohet se të gjithë personat në Kosovë kanë mundësi t'i ushtrojnë në menyrë efektive të drejtat dhe liritë të mbrojtura me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Institucioni siguron mjete për shqyrtim dhe kompenzim të çdo akti, lëshimi apo vendimi që përbën keqpërdorim të autoritetit apo shkelje të të drejtave të njeriut nga administrata e përkohshme civile (UNMIK) apo çdo institucioni lokal apo qëndror që krijohet. Ombudspersoni heton ankesat e çdo personi apo entiteti në Kosovë dhe gjithashtu mund të bëjë hetime *ex officio*. Përveç kësaj, Ombudspersoni mund të bëjë rekomandime lidhur me pajtueshmërinë e ligjeve vendore dhe rregulloreve me standardet e njohura ndërkombëtare (shih Aneksin 1).

Jurisdiksioni i Ombudspersonit shtrihet në tërë territorin e Kosovës dhe ai gjithashtu mund të ushtrojë shërbime të mira në emër të kosovarëve jashtë Kosovës. Ai e bëri këtë në një rast gjatë periudhës raportuese (shih Aneksin 2). Në mënyrë që ta publikojë këtë fuqi dhe të u

sigurojë qasje në Institucion të gjithë kosovarëve jashtë territorit të Kosovës, Ombudspersoni përhap informata dhe materiale të aplikimit në jurisdiksonet fqinje dhe më larg.

Duke filluar në vjeshtë të viti 2000, Ombudspersoni u angazhua në aktivitete ekstenzive të arritshme përmes mediave dhe udhëtojë nëpër Kosovë me qëllim që ta bëjë Institucionin të njohur për popull dhe të krijojë kontakte dhe bashkëpunim me vepruesit lokal. Këto iniciativa u plotësuan me fushatën e vetëdijës publike të organizuar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe Këshilli i Evropës, dhe me përkrahje financiare nga qeveria e SHBA-së. Gjatë tërë periudhës raportuese, Ombudspersoni dhe anëtarët tjerë të personelit senior morën pjesë në takime dhe konferenca rajonale dhe ndërkombëtare dhe krijuan marrëdhënie pune me ombuds institucionet, organizatat jo-qeveritare dhe të tjera me interesim për suksesin e Institucionit në të ardhmën. Personelit lokal të Institucionit ka filluar t'i sigurohet trajnim intensiv nga ekspertë ndërkombëtarë dhe nga anëtarë tjerë të personelit me ekspertiza relevante.

Procedurat para Ombudspersonit

Puna kryesore e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë është pranimi dhe hetimi i ankesave prej individëve mbi shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut apo keqpërdorimet e autoritetit nga entitetet qeveritare. Individët që dëshirojnë ta plotësojnë një ankesë në Institucion mbikqyren dhe ndihmohen nga avokatët lokal që punojnë në Institucion. Në rastin kur Institucioni i Ombudspersonit nuk mund ta shqyrtojë çështjen e ngritur, personeli i Institucionit e këshillon ankuesit për opcionet tjera. Që nga hapja formale e Institucionit, përafërsisht 1000 njërëz e vizituan Institucionin ndërsa 344 kërkesa formale u plotësuan. Shumica e kërkesave janë lidhur me pronësinë (kur qeveria ua ka marrë apo dëmtuar pronën, mospagesa e pagave etj), çështje të punësimit (praktika diskriminuese të pohuara të rekrutimit, largime të padrejta, etj.), çështje të gjykimeve korrekte apo çështje të sigurisë personale (shih Aneksin 1).

Mbi baza formale, Ombudspersoni i ka hudhur poshtë përafërsisht 60% të kërkesave të plotësuar, një pjesë relativisht e vogël e hudhur poshtë në krahasim me institucionet e tjera të ngjajshme gjatë fazës së tyre fillestare. Politikat dhe procedurat për kryerjen e hetimeve të çështjeve janë të ngjashme me ato të ombuds institucioneve tjera, me ç'rast kërkohet shqyrtimi i pikëpamjeve të individëve edhe të qeverisë dhe ku bëhen përpjekje për të zgjedhur problemet përmes ndermjetësimit më parë se përmes propozimeve të diskutueshme. Suksesi i kësaj metode, megjithatë, varet nga pjesëmarrja me vullnet të mirë e të gjitha palëve të përfshira në një çështje.

Ombudspersoni gëzon një bashkëpunim të mirë jozyrtar me policinë e UNMIK-ut. Në mënyrë që të kontribojë për zhvillimin e policisë demokratike në Kosovë, është një praktikë standarde për Institucionin e Ombudspersonit ta informojë policinë e UNMIK-ut për pohimet e shkeljes së të drejtave të njeriut apo keqpërdorimet e autoritetit nga personeli i policisë së UNMIK-ut dhe të kërkojë nga ata të kryejnë hetimet e tyre të mbrendshme lidhur me ato pohime. Kur t'i përfundojnë hetimet e tyre, autoritetet e policisë së UNMIK-ut normalisht ia përcjellin raportin e tyre Ombudspersonit i cili pastaj ndërmerr masa sipas nevojës.

Edhe pse Ombudspersoni nuk ka jurisdikson për t'i hetuar ankesat kundër KFOR-it, një numër i madh i individëve i kanë plotësuar kërkesat pranë Ombudspersonit lidhur me shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut apo keqpërdorimet e autoritetit nga personeli i KFOR-it. Ombudspersoni i ruan kopjet e këtyrë kërkesave dhe ia përcjellë origjinalin KFOR-it për

konsiderimin e tyre. Në shumicën e rasteve, KFOR-i ia percjellë çështjet kontigjenteve kombëtare relevante dhe pastaj e informon Ombudspersonin. Me 5 janar 2001, KFOR-i hungarez në Prishtinë organizoi një takim me përfaqësuesit e KFOR-it nga batalionet nacionale të ndryshme, të cilat u informuan nga Ombudspersoni për Institucionin dhe rolin e tij në Kosovë.

Ombudsperson ka kompetencë të hapë hetime me vetëiniciativë në rastet kur mund të ketë shkelje të drejtave të njeriut dhe keqpërdorime të autoritetit (p.sh. mbi baza *ex officio*). Ombudspersoni ka hapur 15 hetime *ex officio* prej 21 nëntorit 2000 deri më 30 qershor 2001. Si dallim fillestar në mes të hetimit *ex officio* dhe hetimit të bërë lidhur me një kërkesë individuale është zanafilla e çështjes, të dhënat statistikore të siguruara në përmbledhjen e çështjeve në Aneksin 1 i mbulojnë të dy llojet e hetimeve.

Edhe para se ta hetojë çështjen, Ombudspersoni ka fuqi të kërkojë nga autoritetet qeveritare të veprojnë apo të mos veprojnë në rrethana që mund të rezultojnë me një paragjykim të papërmirësueshëm ndaj të drejtave të ankuesit. Ombudspersoni zakonisht kërkon nga autoritetet që të ndërmarrin "masa të përkohshme" vetëm deri sa të vazhdojnë hetimet e tij mbi çështjen. Këto kërkesa nuk nënkuptojnë gjetje të shkeljeve të të drejtave të njeriut apo keqpërdorim të autoritetit. Prej 21 nëntorit 2000 deri më 30 qershor 2001, Ombudspersoni ka bërë pesë kërkesa autoriteteve qeveritare të ndërmarrin masa të përkohshme. Ai konsideron se dy nga këto kërkesa kanë qenë të suksesshme, një ka qenë pjesërisht e suksesshme dhe dy nuk kanë qenë të suksesshme (shih Aneksin 1).

Në maj të vitit 2001, Ombudspersoni ka filluar t'i organizojë "Ditët e Hapura" të rregullta. Këto Ditë të hapura, të cilat mbahen çdo të enjtën e dytë, sigurojnë një mundësi për pjesëtarët e shoqërisë që ta takojnë personalisht Ombudspersonin më qëllim që t'i diskutojnë çështjet e tyre apo të ngrisin çështje tjera brengosëse. Gjatë pesë ditëve të hapura që janë mbajtur në maj dhe qershor 2001, përafërsisht 70 persona janë takuar me Ombudspersonin.

Kërkesat për intervenime politike

Rregullorja e ndalon Ombudspersonin të hetojë ankesat kundër KFOR-it apo kundër Republikës Federative të Jugosllavisë, Serbisë, apo entiteteve tjera qeveritare ose autoriteteve jashtë Kosovës. Në të njejën kohë sjellja e veprimtarëve të tillë mund të ndikojë negativisht në të drejtat e njeriut të individëve brenda Kosovës. Në rrethana të tilla, rrugëdalja e vetme për Ombudspersonin është të kërkojë përkrahje politike nga personat që kanë pushtet të ndikojnë në sjelljen e këtyre veprimtarëve. Gjatë periudhës që mbulohet me këtë raport, Ombudspersoni i ka bërë katër kërkesa të tilla me shkrim, një Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, një Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s dhe dy Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombëve të Bashkuara (shih Aneksin 2). Dhe lidhur me Raportin Special Nr.1, Ombudspersoni ka rekomanduar që PSSP-ja ta inkurajojë KFOR-in të krijojë policia të arsyeshme dhe procedura të arritshme për individët të cilët ankohen kundër KFOR-it (shih Aneksin 1).

Bashkëpunimi me institucionet e tjera Evropiane dhe ndërkombëtare

Në pajtim me caktimin e përgjegjësive të paraqitura në Rezolutë 1244 të Këshillit të Sigurimit të KB , Misionit të OSBE-së në Kosovë (OMIK) i është caktuar përgjegjësia për krijimin e

Institucionit të Ombudspersonit. OMIK ka qenë një faktor që ka ndihmuar për të krijuar infrastrukturën dhe për të lehtësuar punën e Institucionit gjatë fazave të hershme të veprimit. Për shembull, OMIK i ka vendosur Zyrtarët e ndërlidhjes me Ombudspersonin në zyrat rajonale të OMIK–ut për ta ndihmuar Institucionin e Ombudspersonit në publikimin e aktiviteteve të tij, për të përcjellur ankesa prej individëve të cilët kanë vështirësi për të arritur në Institucion, për të rregulluar vizita të Ombudspersonit në terren dhe për të siguruar lloje të ngjajshme të përkrahjes .

Institucioni i Ombudspersonit në Kosovë ka krijuar bashkëpunim të mira me institucionet nëpër Evropë, shumica prej të cilave kanë siguruar ndihme teknike dhe trajnime. Në veçanti, organizatat Evropiane ndërqeveritare dhe institucionet e Ombudspersonit nga vendet e tjera Evropiane kanë siguruar ndihmë intensive Institucionit të Ombudspersonit gjatë tetorit 2000 për t'u siguruar që Institucioni të fillojë punën nga një bazë e fuqishme. Gjatë këtij muaji, Institucioni, Këshilli i Evropës dhe OSBE-ja kanë organizuar një seminar në Prishtinë për të ndihmuar në zhvillimin e sistemit për udhëheqjen dhe menagjimin e çështjeve dhe në përpilimin e Rregullave Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit. Seminari tuboi shumë ekspertë duke përfshirë edhe përfaqësuesit e Zyrës së Ombudspersonit në Greqi dhe Suedi. Këshilli i Evropës gjithashtu siguroi një ekspert nga Zyra e Ombudspersonit të Suedisë i cili bëri rekomandime lidhur me politikat dhe procedurat dhe i cili ndihmoi që Institucioni të zhvillojë më tutje kapacitetin e tij në menagjimin e çështjeve. Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut në OSBE (ZIDDNJ) gjithashtu siguroi disa ditë të trajnimit mbi të drejtën ndërkombëtare dhe të drejtat e njeriut për personelin e Institucionit të Ombudspersonit.

Në shkurt të vitit 2001, përfaqësuesit e zyrës së Ombudspersonit Grek erdhen në Institucion që të sigurojnë një trajnim me të thellë për juristët lokal. Gjithashtu dy zëvendësat lokal morën pjesë në tryezën e rumbullakët të ombuds institucioneve të Evropës juglindore, të udhëhequr nga Ombudspersoni Kroat dhe Këshilli i Evropës.

Në mars të vitit 2001, Këshilli i Evropës e ftojë Ombudspersonin në Strasburg për një seri konsultime, ku si kulminacion qe prezentimi i tij Grupit Raportues për Stabilitet Demokratikë (GRE- SD) të Komitetit të Ministrave. Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur financoi zëvendësin lokal dhe kryesuesin lokal të hetimeve për të marrë pjesë në hapjen formale të Institucionit të Ombudspersonit në Shqipëri.

Në maj të vitit 2001, Ombudsoersoni Spanjoll dhe Ombudspersoni i Katalonisë ofruan një vizitë studimi dy zëvendësive lokalë dhe kryesuesit lokalë të hetimeve. Një delegacion nga Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombëve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut gjithashtu e vizitoi institucionin për ta shtuar bashkëpunimin në të ardhmën. Këshilli i Evropës e sigurojë një ekspert në administratë dhe menagjiment i cili e ndihmoi Institucionin e Ombudspersonit për të krijuar praktike efektive në këto sfera.

Në vazhdim të asaj që u tha me lartë, Ombudspersoni thirri organizatat simotra nga vendet tjera Evropiane për të ndjekur çështje të caktuara. Në fund të prillit të vitit 2001, Ombudspersoni kontaktoi me Ombudspersonin e Rosisë për të kërkuar nga ai që ta inkurajojë Ministrinë e Jashtme Ruse që t'u sigurojë shërbime të nevojshme civilëve rusë që përballën me akuza kriminale në Kosovë. Në qershor të vitit 2001, Ombudspersoni kontaktoi me Ombudspersonin Spanjoll për të parë nëse ai do të mund të siguronte informata rreth qëllimit të qeverisë Spanjolle lidhur me sigurimin urgjent të kujdesit mjekësorë një qytetari të Kosovës i cili ishte i lënduar rëndë në një ndeshje komunikacioni ku ishte i përfshirë KFOR-i Spanjoll.

Gjatë periudhës së raportimit, Ombudspersoni bëri disa prezentime formale mbi mandatin dhe punën e Institucionit me organizatat ndërkombëtare. Në tetor të vitit 2000, ai bëri një prezantim në Varshavë në takimin e OSBE-së mbi Zbatimin e Përmasave Njerëzore dhe në nëntor 2000, para Asamblesë së Përgjithshme të Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Pragë.

Marrëdhëniet me media

Që nga emërimi i tij, Ombudspersoni krijoi marrëdhënie të mira me të gjitha mediat më kryesore në Kosovë dhe me mediat kyçe në territorin e Serbisë. Mediat i ndihmuan Institucionit në promovimin e vetëdijës së publikut rreth çështjeve kryesore lidhur me mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë, poashtu edhe në edukimin e publikut lidhur me rolin e Institucionit. Interesimi i mediave në Institucion ishte shumë i madh, më se 200 raporte ose artikuj u paraqitën gjatë periudhës raportuese. Në janar të vitit 2001, Rregullat Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit u botuan në tërësi në *Koha Ditore*, një nga gazetatat kryesore në Kosovë.

Fondet

Deri më sot, Institucioni i Ombudspersonit është financuar nga qeveria e Shteteve të Bashkuara dhe nga Këshilli i Përhershëm i OSBE-së. Qeveria Zviceriane poashtu siguroi fondet për tri pozitat e personelit senior vendor.

Fondacioni për Shoqëri të Hapur në Kosovë siguroi fonde për disa udhëtime zyrtare të personelit lokal dhe për disa aktivitete të trajnimit..

Në bazë të rregullorës, Institucioni mund të kërkoj për buxhetin e tij mund të kërkojë kontribute për buxhetin e tij edhe nga burimet vendore (buxheti i Konsoliduar i Kosovës) edhe nga donatorët ndërkombëtarë.

Problemet e ballafaquara

Gjatë shtatë muajëve të parë të egzistimit, Institucioni i Ombudspersonit ishte ballafaquar me një numër pengesash gjatë përmbushjes së mandatit të tij.

Mbajtja dhe rekrutimi i personelit:

Organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë e paguajnë më tepër personelin lokal se sa që mundet Institucioni i Ombudspersonit. Për shëmbull, një anëtar i personelit senior profesional vendor i punësuar në OMIK në pozitën e Zyrtarit të ndërlidhjes (p.sh. jashtë Prishtinës), paguhet gati 40% më tepër se një jurist vendor i punësuar nga Ombudspersoni në Prishtinë. Mospajtime të ngjashme në bord krijuan një situatë shumë të vështirë për Institucionin në rekrutimin dhe mbajtjen e personelit të kualifikuar vendor. Në mbylljen e periudhës raportuese, vendet e lira për përkthyes senior dhe për personel të informatikës të shpallura në fillim të vitit 2001 ende mbeten të lira, duke ndikuar negativisht në kapacitetin e Institucionit. Egziston rreziku se personeli kryesor i Institucionit do të punojë për një kohë të

shkurt, dhe do të kërkojnë që të punësohen në organizatat ndërkombëtare ku pagesat janë shumë më të larta.

Qasja e personave të cilët jetojnë jashtë Prishtinës në Institucionin e Ombudspersonit : Gjatë periudhës së raportimit, Institucioni i Ombudspersonit ishte i shqetësuar për vështirësit që mund të kenë individët të cilët jetojnë jashtë Prishtinës lidhur me qasjen adekuate në Institucion, një brengë që ende mbetet serioze. Ky problem është i rëndë veçanarisht për anëtarët e pakicave etnike, të cilët shumë shpesh jetojnë nëpër komunitete të izoluar pa ndonjë letësim komunikimi dhe se ata do të përballen me rrezikun e sigurisë personale nëse largohen nga këto komunitete. Edhe pse institucioni i Ombudspersonit kishte shpresuar të hapë zyret e veta në rajonet ku është numër më i madh i popullatës së minoriteteve, por kjo nuk ishte e mundur të realizohet për të mungesës së fondeve.

Me qëllim që më mirë të i përgjigjet problemeve të qasjes së minoritetve në Institucion, Institucioni i Ombudspersonit ka paraqitur disa praktika që të ndihmojë në lehtësimin e qasjes, për shembull, ka punësuar një jurist i cili jeton dhe punon në pjesën veriore të Mitrovicës. Juristët vendorë të cilët punojnë në Prishtinë në Institucion kanë bërë rregullisht vizita nëpër zonat ku jetojnë minoritetet afër Prishtinës.

Që nga tetori i vitit 2000, Ombudspersoni së bashku me Zëvendësat e tij kanë udhëtuar nëpër rajone të ndryshme të Kosovës me qëllim që të takohen me anëtarë të komuniteteve të minoriteteve, për t'i vizituar enklavat dhe për të promovuar pajtimin. Në çdo zonë ku ka pasur ndonjë qendër të paraburgimit, në udhëtim është përfshirë edhe vizita asaj qendre, përfshirë edhe diskutimet me autoritetet e qendrës së paraburgimit dhe me të paraburgosurit. Poashtu janë vizituar një numër i komunave, me qëllim që të u prezantohet Institucioni partnerëve vendorë dhe ndërkombëtarë dhe është diskutuar për vështirësitë me të cilat konfrontohen komunitetet atje. Në vendet e vizituara përfshihet Mitrovica, Peja, Prizreni, Gjilani, Rahoveci, Zveçani, Lipjani, Deçani, Kamenica, dhe Vitia. Pas inaugurimit të asambleve komunale të zgjedhjeve lokale të vjeshtës së vitit 2000, Ombudspersoni u angazhua në aktivitetet e informimit me qëllim të informimit të këtyre institucioneve të reja demokratike për rolin dhe funksionin e Institucionit të Ombudspersonit dhe të diskutoj me to problemet me të cilat ballafaqohen komunitetet dhe me natyrën e bashkëpunimit me administratën ndërkombëtare. Përafërsisht një javë pasi që Ombudspersoni vizitonte një zonë specifike, një ose më shumë juristë vendor të institucionit vizitonin të njëjtën zonë me qëllim që të ndihmojnë individëve të cilët dëshironin të parashtronin kërkesa para Institucionit ose për të ndjekur qështje tjera me interes.

Prospektet në të ardhmën

Korniza Kushtetuese për Kosovën përfshinë edhe Institucionin e Ombudspersonit në rregullat ligjore të krahinës, një zhvillim pozitiv i cili siguron së paku vazhdimin formal të institucionit. Përveç sigurimit të vendit të përhershëm në Kosovë për Institucionin, ajo gjithashtu i lejon Institucionit të kërkojë që një Odë Speciale të Gjykatës Kushtetuese të vendosë nëse një vendimi Institucioni të përkohshëm të vetqeverisjes cenon pavarësinë dhe përgjegjësinë e institucionit të Ombudspersonit.

Kredibiliteti në të ardhmën i Institucionit do të varet nga niveli i lartë i anagazhimit profesional dhe nga ekspertiza e personelit lokal. Pra është me rëndësi që të vazhdohet me sigurimin e trajnimeve të përgjithshme dhe të hollësishme, shpërblimeve në suaza të vendit të punës, dhe kushteve të punës për tërë personelin vendor.

Institucioni i Ombudspersonit mbetet seriozisht i brengosur për qasjen jo adekuate në këtë Institucion të anëtarëve të komuniteteve të minoritetëve të cilët jetojnë jashtë Prishtinës, momentalisht dhe aq më shumë gjatë periudhës kalimtare të parashikuar me Kornizën Kushtetuese. Në këto rrethana, krijimi, mbajtja dhe realizimi i një prezence të dukshme në terren të Institucionit të Ombudspersonit është një prioritet i madh.

Bazat financiare për ta siguruar arritjen e këtyre dy qëllimeve nuk janë siguruar në asnjë mënyrë.

Marek Antoni Nowicki
Ombudspersoni

Aneksi 1**Përmbledhja e Çështjeve****21 nëntor 2000 deri më 30 qershor 2001**

Që nga hapja e Institucionit të Ombudspersonit , rreth 1000 veta kanë vizituar Institucionin që të këshillohen dhe/ose që të plotësojnë aplikacionet.

ÇËSHTJET E REGJISTRUARA PËRKOHËSISHT : 344**PËRKATËSIA ETNIKE E PARASHTRUESVE TË KËRKESAVE**

Shqiptarë : 228
Serb: 112
Të tjerë: 32 (9 Boshnjak; 9 Romë; 9 Turq; 1 Malazez)
Nuk ceket përkatësia: 4

PALET PËRGJEGJËSE

UNMIK--u: 148
KFOR-i: 62
Autoritetet Komunale : 62
Të tjerët: 58

ÇËSHTJET E SHPALLURA TË PAPRANUESHME : 148

Ombudspersoni nuk mund të hetojë ankesat kundër palëve përgjegjëse: 56
 (46 KFOR-i; 4 Serbia; 3 OJQ; 2 Gjermania; 1 person privat)

Parashtruesit e kërkesave kanë dështuar të shfrytëzojnë mjetet tjera: 56

Dëshmitë ose vendimet përfundimtare kanë ndodhur para 30 qershorit 2000
 (data kur Institucioni i Ombudspersonit është krijuar): 26

Të pabazuara (nuk ka çështje për t'u shqyrtuar): 9

Tema e çështjes nuk është në jurisdiksonin e Ombudspersonit: 1

Çështjet e ndërprera gjatë procedurave (të zgjedhura ose të mbyllura në baza tjera përveç pranueshmërisë): 28

(12 persona të ripunësuar nga punëdhënësit e tyre të paraluftës; 10 persona kanë marrë pagesat për punën e bërë disa muajshe ; 3 persona kanë fituar ndihmë sociale për periudhën e mëparshme ose të tanishme me zotësi juridike; 2 persona janë pranuar në programet edukative ; 1 kontratë për shitjen e pronës është bërë valide).

ÇËSHTJET E PRANUESHME / HETIMET E HAPURA: 10

HETIMET E HAPURA EX OFFICIO : 15

REPORTET PËRFUNDIMTARE TË LËSHUARA MBI HETIMET: 2

TEMAT E ÇËSHTJEVE :

E drejta për marrëdhënie pronësore: 141 (48 marrja e pronës /pa kompensim; 38 dëmtim i pronës/pa kompensim ; 22 mospagesë e pagave ; 17 qasje në shtëpi ose pronë tjetër; 5 mospagesë e pensioneve ; 3 mos lëshimi i pronës së okupuar në mënyrë ilegale; 8 të tjera)

Çështjet për marrëdhënie punësimi: 92 (35 dështim për të fituar vendin e punës nëpërmjet procesit të punësimit përmes konkursit; 26 largim nga puna ; 12 dështim për t'u ofruar vendi i punës para luftës; 19 të tjera).

E drejta për gjykim korrekt: 38 (21 e drejta për në gjyq (13 nuk kanë pasur mundësi të ngrisin çështjen para gjykatave kompetente; 6 dështimi i autoriteteve për ekzekutimin e urdhëresave ose të vendimeve të gjyqit; 2 gjykata nuk ka qenë e pavarur dhe e paanshme); 8 çështjet e procedurave penale (1 dëshmia nuk e përkrahu dënimin; 1 ndihmë jo efektive e avokatit; 1 zgjatja e procedurave; 2 pabarazia e palëve lidhur me dëshmitë; 3 të tjera); 3 zgjatja e procedurave civile; 6 gjykim korrekt (të tjera)).

E drejta për liri 30 (5 pa urdhër arresti; 5 pa mjete për të sfiduar ligjshmërinë e paraburgimit; 4 nuk janë sjellur me kohë para autoriteteve gjyqësore; 4 nuk janë liruar në kohën e caktuar nga gjykatësi; 2 pa urdhër për arrestim; 1 pa informata lidhur me akuzën; 1 shumë gjatë i paraburgosur; 1 nuk është liruar në kohën e caktuar me ligj; 2 nuk ka pasur mjetet për të fituar kompensimin për paraburgim të pa ligjshëm; 5 të tjera)

Pandëshkueshmëria 30 (5 dështim që në mënyrë adekuate të hetohen pohimet për trajtim çnjerëzor dhe degradues ose shkelje të së drejtës për jetë; 25 dështim që të hetohen krimet që prekin të drejtën për siguri, të drejtën për respektimin e jetës private, etj.)

Keqpërdorim i autoritetit: 20 (11 dështim i autoriteteve administrative që t'u përgjigjen kërkesave të duhura; 5 vendime arbitrare ose diskriminuese nga ana e administratës; 4 të tjera)

E drejta për ndihmë sociale dhe/ose një standard adekuat për jetë: 17

E drejta për respektimin e shtëpisë: 12

Lirimi nga trajtimi çnjerëzor ose degradues: 10

Diskriminim/ mbrojtje e barabart: 10

Të tjera: 23 (çështjet e papërfshira më lart dhe të ngritura më pak se pesë herë)

KËRKESË PËR MASA TË PËRKOHËSHME

30 nëntor 2000: kërkesë Departamentit për Shërbime Publike që të përmbahet nga çkyqja e individëve nga shërbimet publike, deri sa Ombudspersoni të bëjë hetimet mbi operacionin e skemës së përjashtimeve (**Pjesërisht e suksesshme**: DSHP krijoi Grupin Punues që të shqyrtojë procedurën për shqyrtimin e kërkesave për përjashtim, por fokusi primar është në veprimet e ardhshme të merren parasysh përjashtimet e anëtarëve të minoriteteve etnike, më parë se të shqyrtohen pohimet mbi defektet e skemës origjinale).

19 shkurt 2001: kërkesë që Kryesuesi i Departamentit për çështje Juridike pranë UNMIK-ut të lirojë nga paraburgimi një individ i cili ka qenë i paraburgosur në mënyrë të paligjshme dhe ta informojë atë mbi ligjin e zbatueshëm dhe procedurat për kompensim për paraburgim të paligjshëm (**E pasuksesshme**: individit as nuk është liruar e as nuk është informuar për të drejtën e tij për kompensim. Deri më 30 qershor 2001, individit ende po mbahet në paraburgim).

6 mars 2001: kërkesë që Kryesuesi i Departamentit Rajonal për Kulturë, Arsim dhe Sport pranë UNMIK-ut në Mitrovicë dhe të veprojë në atë mënyrë që të mbrojë materialet në gjuhën Serbe dhe në gjuhët e tjera të minoriteteve në Bibliotekën e Qytetit në Mitrovicë (**E suksesshme**: UNMIK-u filloi hetimet dhe mori masat mbrojtëse për literaturën në gjuhën e minoriteteve që përdoret në zonën e shumicës etnike). (Shih përmbledhjen e raportit final të çështjes në faqen 28)

4 maj 2001: kërkesë që PSSP të veprojë që të suspendojë vendimin e Asamblesë Komunale në Gillogovcit që të demolojë një numër të lokaleve afariste deri sa të merret vendimi përfundimtar i shkallës së dytë nga autoritetet administrative dhe/ose nga gjykata kompetente (**E suksesshme**: më 7 maj, PSSP lëshoi një vendim administrativ ku suspendoi zbatimin e vendimit duke pritur rezultatet e procedurave të ankimit që ishin duke i ndjekur individët e dëmtuar).

7 maj 2001: kërkesë që PSSP të suspendoj zbatimin e vendimit të Njësisë për regjistrimin e Afarizmit pranë UNMIK-ut për mos dhënie e lejes së punës biznesit i cili kishte punësuar 300 punëtorë (**E pasuksesshme**: kërkesa është refuzuar).

INSTITUCIONI I OMBUDSPERSONIT në KOSOVË

Përmbledhje

RAPORTI SPECIAL Nr. 1

Mbi pajtushmerinë e standardeve të njohura ndërkombëtare me Rregulloren e UNMIK –ut Nr. 2000/47 mbi statusin, privilegjet dhe imunitetin e UNMIK-ut dhe KFOR-it dhe personelit të tyre (18 gusht 2000) dhe në zbatimin e rregullorës së lartëpërmendur

adresuar

Z. Hans Hakerup, Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara

26 prill 2001

Në pajtim me autorizimet e dhëna atij me nenit 4.3 dhe 4.9 të Rregullorës së UNMIK-ut 2000/38 mbi Krijimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë dhe rregullën 22, paragrafi 3 dhe 4 të Rregullave Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, Ombudspersoni ka lëshuar raportin special të mësipërm.

Ombudspersoni ka gjetur se Rregullorja e UNMIK–ut Nr. 2000/47 nuk është në pajtueshmëri me standardet e njohura ndërkombëtare lidhur me fushën e dhënës së imunitetit të KFOR-it dhe UNMIK-ut në kapacitetet e tyre institucionale. Ai gjithashtu ka gjetur se Rregullorja nuk është 'në pajtim me ligjin' në kuptimin e Konventës për të Drejtat e Njeriut, në pjesën ku ata janë të paarrtshëm për publikun, dispozitat e tyre të paqarta dhe dështimin e tyre për ti mbrojur individët në Kosovë nga sjellja e arbitrare e UNMIK-ut ose KFOR-it apo personelit të tyre.

Ombudspersoni gjithashtu ka gjetur se Rregullorja e UNMIK –ut Nr. 2000/47 nuk është në pajtueshmëri me këto dispozita vijuese të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut: Nenin 6, individët nuk kanë një forum gjyqësor që ndeshet me kërkesat e atij neni lidhur me ngritjen e kërkesave civile kundër UNMIK-ut ose KFOR-it apo personelit të tyre; Neni 1 i Protokolit Nr.1 , KFOR-i dhe UNMIK-u mund ta okupojnë apo ta dëmtojnë pasurinë pa i paguar kompenzimin pronareve të pasurisë; Nenin 8, UNMIK-u dhe KFOR-i mund të ja privojnë çasjen individëve në shtëpitë e tyre; Neni 15, ku UNMIK-u dhe KFOR-i i kanë kufizuar këto dhe të drejtat tjera më tepër se sa është e nevojshme, edhe nëse situata në Kosovë mund të konsiderohet se është "emergjencë publike ku kërcenohet jeta e kombit".

Ombudspersoni ka rekomanduar që Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, jo me vonë se **29 qershor 2001**, të ndryshojë Rregullorën e UNMIK-ut 2000/47 të kufizoj imunitetin e KFOR-it dhe UNMIK-ut në kapacitetin e tyre institucional, të nxjerr një rregullore që ju garanton individëve në Kosovë çasje efektive në një tribunal adekuat për definimin e kërkesave civile kundër KFOR-it dhe UNMIK-ut, dhe të sigurojë një përhapje efektive të të dyja rregulloreve në të gjitha gjuhët që përdoren në Kosovë. Ombudspersoni gjithashtu ka rekomanduar që Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të ndër marrë hapa të duhur për ta ikurajuar KFOR-in që të krijojë dhe të zbatojë një politikë të qendrueshme lidhur me pagimin e kompensimit personave të cilëve KFOR-i ja ka okupuar ose dëmtuar pronën.

PËRGJEGJJA: Me **28 qershor 2001**, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm e informoi Ombudspersonin se çështjet e ngritura në këtë raport janë "nën konsiderim aktiv" në zyrën e tij dhe që konsultimet po mbahen me Shtabin e Kombëve të Bashkuara dhe tjerët me qëllim që ti ipet një përgjegjje përmbajtësore raportit.

Me **29 qershor 2001**, raportet nëpër mediat e shkruara lokale tregojnë se KFOR-i mund të jetë në proces të krijimit të kanaleve përmes të cilave individët mund të plotësojnë ankesa kundër KFOR-it.

INSTITUCIONI I OMBUDSPERSONIT NË KOSOVË

Përmbledhje

RAPORTI SPECIAL Nr.2

Mbi aspektet e caktuara të Rregullorës së UNMIK nr.2000/59
që ndryshon e Rregullorën e UNMIK-ut nr.1999/24
mbi ligjin e aplikueshëm në Kosovë(27 tetorë 2000)

adresuar

Z. Hans Haekkerup
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara

30 maj 2001

Në pajtim me autorizimet e dhëna në bazë të nenit 1.1 të Rregullorës së UNMIK-ut nr 2000/38 mbi krijimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovës dhe Rregullës 22, paragrafi 3 dhe 4 të Rregullave Procedurale të Ombudspersonit, Ombudspersoni ka lëshuar raportin special të mësipërm.

Ombudspersoni ka gjetur se Rregullorja e UNMIK-ut 2000/59 që ndryshon Rregullorën e UNMIK-ut 1999/24 mbi ligjin e aplikueshëm në Kosovë nuk është në pajtueshmëri me Rezolutën 1244(10 qershor 1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në atë që nuk i mbron në mënyrë adekuate standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut në sistemin ligjor në Kosovë. Në bazë të Rezolutës 1244 UNMIK-u zëvendëson shtetin, një nga përgjegjësitë kryesore të të cilit është mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut. Ombudspersoni ka gjetur se PSSP, si drejtues i këtij zëvendësimit të shtetit, ka obligim afirmativ që të ushtrojë autorizimet e tij legjislative dhe ekzekutive që të sigurojë që standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut të jenë të respektuara dhe të integruara në Kosovë. Ombudspersoni ka gjetur se as kjo Rregullore e asnjë Rregullore tjetër e UNMIK-ut nuk vendos instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut si të detyrueshme në ligjin vendor të Kosovës.

Ombudspersoni rekomandon se Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, jo më vonë se **27 korrik 2001**, të ndryshojë Rregullorën e UNMIK-ut 2000/59 dhe të qartësojë parësinë e instrumenteve ligjore ndërkombëtare të të drejtave të njeriut në rendin ligjor të Kosovës.

INSTITUCIONI I OMBUDSPERSONIT NË KOSOVË

Përmbledhje

RAPORTI SPECIAL Nr.3

Mbi pajtueshmërinë e privimit të lirisë sipas 'Urdhëresave Ekzekutive'
me standardet e njohura ndërkombëtare

adresuar

z. Hans Haekkerup

Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara

29 qershor 2001

Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 1.1 dhe 4.1 të Rregullorës së UNMIK-ut nr. 2000/38 mbi krijimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë dhe të Rregullës 22, paragrafi 3 dhe 4 të Rregullave Procedurale të Ombudspersonit, Ombudspersoni ka lëshuar Raportin special të mësipërm.

Ombudspersoni ka gjetur se privimi nga liria i caktuar sipas 'Urdhëresave Ekzekutive' ose me ndonjë formë tjetër të udhëzimit, dekretit ose vendimit ekzekutiv të lëshuar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (PSSP), nuk është në pajtueshmëri me standartet e njohura ndërkombëtare. Ai ka gjetur se një privim i tillë i lirisë nuk mund të konsiderohet si legjitim në kuptim të paragrafit 1 të nenit 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, se mungesa e kontrollit gjyqësor mbi privimin e lirisë të vendosur sipas Urdhëresave ekzekutive përbën shkelje të paragrafit 3 dhe 4 të nenit 5 të Konventës, si dhe mungesa të drejtës së detyrueshme për kompensimin për privimin e paligjshëm të lirisë përbën shkelje të paragrafit 5 të nenit 5.

Ombudspersoni ka rekomanduar që PSSP **menjëherë** ta ndërprejë praktikën e lëshimit të urdhëresave ekzekutive që caktojnë privim të lirisë për cilindo individ në Kosovë. Më tutje, Ombudspersoni rekomandon se PSSP, jo më vonë se **20 korrik 2001**, të themelojë një ose më tepër kolegje të përbërë nga gjykatësit ndërkombëtarë për të shqyrtuar, në baza urgjente, legjitimitetin e paraburgimit të individëve të cilët momentalisht janë të privuar nga liria në bazë të urdhëresave ekzekutive, dhe që ky shqyrtim të jetë në pajtim me kërkesat e nenit 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ombudspersoni poashtu ka rekomanduar që PSSP duhet të obligohet që t'i përmbahet vendimeve mbi privimin e lirisë të caktuara nga ana e kolegjeve gjyqësore, që janë themeluar në pajtim me rekomandimet .

Ombudspersoni poashtu ka rekomanduar që PSSP, jo më vonë se më **31 gusht 2001**, të shpallë një Rregullore që themelon bazën ligjore për kërkesat për kompensim për privimin e paligjshëm të lirisë dhe për procedurat e duhura gjyqësore, dhe që me datën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, ta përhapë atë përmes të gjitha kanaleve të mundshme dhe në të gjitha gjuhët që përdoren në Kosovë. Ombudspersoni më tutje rekomandon që Rregullorja e re do të duhej të u shpërndahet të gjithë personave të cilët kanë qenë të privuar nga liria në bazë urdhëresave ekzekutive të lëshuara nga PSSP, dhe të gjithë gjykatësve, zyrtarëve të gjyqit ose të tjerëve të cilët ushtrojnë autoritetin gjyqësor në Kosovë.

OMBUDSPERSON INSTITUTION in KOSOVO**Përmbledhje****RAPORT*****Ex officio* Nr. Reg. 03/01****Lidhur me mohimin për dhënien e licencës për transmetim mbarë kosovar
radios "Kosova e Lirë"****27 prill 2001**

Ombudspersoni në Kosovë, në pajtim me nenin 4.4 të Rregullorës së UNMIK Nr. 2000/38 mbi Krijimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë dhe rregullës 18 të Rregullave Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit ka publikuar raportin e mësipërm të çështjes.

Ombudspersoni ka vlersuar procedurat dhe mekanizmat që kanë udhëhequr vendimet e marra për licencim lidhur me konkursin e dhjetorit të vitit 2000 për transmetim mbare kosovar nëse pajtohen me kushtet procedurale të nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që udhëheq lirinë e shprehjes.

Ombudspersoni vëren se radio "Kosova e Lirë" ishte e informuar mirë për kriteret dhe procedurat për marrjen e lejes për transmetim në tërë teritorin e Kosovës dhe se ka pasur mundësi të merrë pjesë në konkurs dhe të ndikoj në procesin e marrjes së vendimit, por radio "Kosova e Lirë" ka zgjedhur që të mos e shfrytëzoj mundësin që të ankohe kundër vendimit negativ ndaj kërkesës së saj .Ombudspersoni gjithashtu vëren se nuk ka asnjë fakt i cili le të kuptojmë se ka anshmëri nga bordi për licencim ose nga komisioneri për media është bërë sjellje jo e drejtë në procesin e licensimit .

Ombudspersoni, konkludon se në bazë të nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut nuk ka të shkelje të procedurës. Po ashtu nuk ka pas as shkelje të të drejtave të njeriut apo keqpërdorim të autoritetit në bazë të nenit 3.1 të Rregullorës 2000/38 të UNMIK.

INSTITUCIONI I OMBUDSPERSONIT në KOSOVË**Përmbledhje****RAPORT****Nr. i Regjistrit 159/01**

Lidhur me shkatërrimin e pohuar të pronës kulturore nën mirëmbajtje dhe përkujdesje të bibliotekës së qytetit të Mitrovicës

18 maj 2001

Ombudspersoni i Kosovës, në pajtim me Nenin 4.4 të Rregullorës së UNMIK-ut 2000/38 mbi themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë dhe Rregullës 18 të Rregullave Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, ka publikuar raportin e mësipërm.

Ombudspersoni konsideron se nuk është e mundur të vërtetohen faktet lidhur me largimin dhe/ose shkatërrimin e librave, dokumenteve apo pronës tjetër kulturore serbe nga biblioteka e qytetit të Mitrovicës ku nuk është bërë inventari i koleksionit të bibliotekës së qytetit në Mitrovicë nuk është bërë me vite, ndërtesa e bibliotekës ishte e hapur dhe pa mbikqyrje për përfarsisht një muaj gjatë verës së vitit 1999, si dhe ekzistojnë pengesa tjera për ta caktuar saktësisht gjendjen e koleksionit. Në këto rrëthana, Ombudspersoni, nuk mund të konkludojë nëse ka ndodhur apo jo shkelja e të drejtave të njeriut apo keqpërdorimi i pushtetit.

Në anën tjetër, Ombudspersoni shprehu përkrahjen e tij rekomandimeve të theksuara në dy raportet e përgatitura nga ana e dy delegacioneve të ekspertëve të pavarur të cilët qenë ngarkuar nga UNMIK-u që të merrën me çështjet të ngritura në ankesë. Duke marrë parasysh këtë, Ombudspersoni rekomandon që, jo më vonë se 15 qershori 2001, UNMIK-u do të duhej të formojë një komision të pavarur për ta ndihmuar librarinë e qytetit në Mitrovicë për kryerjen e inventarit dhe përmirësimin e menagjerimit të koleksionit. Gjithashtu, Ombudspersoni ka rekomanduar se Koordinatori rajonal do të duhej ta informojë Ombudspersonin mbi veprimet e ndërmarra lidhur me këto rekomandime.

PËRGJEGJJA: Më 15 qershor 2001, Koordinatori rajonal i UNMIK-ut mbi kulturën e informoi Ombudspersonin për dy iniciativat e marra:

- 1) është bërë përpjekje për të pranuar personel lokal të kualifikuar për bibliotekën e qytetit të Mitrovicës.
- 2) Unmik-u ka qenë duke bërë bisedime me qeverinë Franceze rreth mundësisë së emërimit të një bibliotekisti profesional të kualifikuar që të ndihmojë në përmirësimin dhe drejtitmin e bibliotekës.

Kordinatori rajonal i UNMIK-ut mbi kulturën gjithashtu ceku se se UNMIK-u do të vazhdojë ta mbikqyrë bibliotekën e qytetit të Mitrovicës.

ANEKSI 2**Tekstet e letrave që kërkojnë të ndërmerren veprime politike**2 shkurt 2001

E nderuara Mary Robinson
 Përfaqësusi i Lartë i Kombëve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut
 8-14 Avenue de la Paix
 1211 Gjenevë 10
 Zvicër

E nderuara Mary Robinson,

Nëpërmjet të kësaj letre unë dëshiroj të ju tërheq vëmendjen për gjendjen e vështirë të njëqind e dyzet e tre njerëzëve, në mesin e të cilëve shumica të mitur, nga një fshatë i Gjakovës në Kosovë të cilët ishin arrestuar më 1999 gjatë luftës që ndodhi në atë vit në Kosovë në qytetin ku ata banonin. Më pas ata ishin transferuar në Nish, në një vend jashtë krahinës ku ata kanë jetuar dhe janë mbajtur atje në paraburgim para procesit gjyqësor. Më 22 maj 2000 Gjykata e Qarkut në Pejë, u mblodh në Nish dënoi të gjithë të njëqind e dyzet e tre banorët me burgime të ndryshme, me sa jam i informuar unë, prej shtatë deri në trembëdhjet vite. Emrat e tyre janë të shënuar në aneksin A.

Ky rast i ka tronditur thellë të gjithë të afërmit e të njëqind e dyzet e tre personave , banorët e tjerë të Kosovës dhe shumë persona jashtë krahinës për shkak të numrit të madh të personave të arrestuar për shkak të kohës së arrestimit të tyre, për shkak të paraburgimit para procesit gjyqësor dhe për seancat gjyqësore jashtë krahinës, të përmbajtjes së aktakuzës (veprimtari terroriste) kundër të gjithëve, për shkak të dënimit të gjatë, të mungesës së sinqeritetit dhe informimit dhe për shkak të vështërsive për të vënë dhe për ta mbajtur kontakun me ata. Si rezultat i tërë kësaj besohet se trupi gjykues ka qenë i një anshëm dhe se ata kurrë nuk kanë pasur mundësi të kenë një proces të drejtë gjyqësor.

Pasi që këtij rasti në kohën e fundit i është kushtuar vëmendje e madhe nga mediat dhe është temë e konsultimeve diplomatike, ju me siguri se jeni të informuar tërësisht ndoshta keni qenë edhe të përfshirë në procesin për gjetjen e një zgjedhje të shpejt.

Kërkesa për të vështruar arrestimin dhe paraburgimin e lartpërmendur vie nga z. Gentilhomme, i cili jeton në Strasburg, kunat i njërit nga qytetarët e arrestuar të Gjakovës. Kërkesa e tij më është paraqitur mua nëpërmjet të shërbimeve të mira të Komisionerit për të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Evropës në Strasburg, z. Gil Robles.

Kjo ankesë formalisht nuk bie nën jurisdiksionin tim për këtë arsye unë kërkoj nga ju që urgjentisht, për hir të atyre të cilët janë të përfshirë, të dënuar për të afërmit a tyre dhe të shumë banorëve në Kosovë, për hir të të drejtave të njeriut edhe për hir të kredibilitetit të drejtësisë dhe të judikaturës në përgjithësi, të bëni gjithçka që është e mundur që këtë rast ta sillni para një zgjidhje të drejtë sa më shpejt që është e mundur.

Ju lutem të jeni të bindur për konsideratën time të lartë.

Me nderime,

Marek Antoni Nowicki
 Ombudsperson

cc: z. Philippe Gentilhomme
 Komisioneri për të Drejtat e Njeriut pranë Këshillit të Evropës
 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
 Kryesuesit të Misionit në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

PËRGJEGJJA: Nuk është marrë asnjë përgjegjje në këtë letër

7 Mars 2001

Z. Hans Hakerup

I Dërguar Special i Sekretarit të Përgjithshëm

I nderuari Z.Hakerup,

Që nga hapja e Institucionit të Ombudspersonit, unë kam pranuar disa kërkesa formale, një peticion të përgjithshëm dhe një numër të ankesave joformale lidhur me vështërsit me të cilat ballafaqohen shumë njerëz të vjetër në Kosovë për të cilët nuk është e mundur që ti fitojnë pensionet e veta.

Këta persona kanë të drejtë për pension (e drejtë e cila përbën të drejtën për pronësi sipas ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut) nëpërmjet kontributeve të rregullta të fondit shtetëror për pensione të ish Jugosllavisë dhe /ose të Republikës Federale të Jugosllavisë. Këto fonde në bazë të njohurive të mia, administrohen nga ana e autoriteteve për pensione në Beograd.

Siç e dini edhe ju, unë nuk kam jurisdikcion për rishikim të këtyre çështjeve kundër Serbis dhe Ish Jugosllavisë. Unë poashtu e di që UNMIK-u nuk ka obligim ligjor që të iu paguaj pensionet personave të cilët e kanë fituar të drejtën për pensione nëpërmjet institucioneve të tjera. Megjithatë, në anën tjetër unë e konsideroj si shumë serioze situatën e njerëzve të vjetër të cilët janë të mvarur nga pensionet me qëllim që ti kalojnë pleqërinë e tyre me dinjitet, por të cilët në disa instanca mezi egzistojnë, kjo është një çështje që meriton një angazhim të nivelit të lart me prezencën e ndërkombëtarëve në Kosovë.

Nga intervistat e juaja të fundit unë vërejta se një nga prioritetet e juaja gjatë afatit të juaj si i Dërguar Special i Sekretarit të Përgjithshëm ,do të jetë që ti përmirsoni marrëdhëniet me autoritetet në Beograd. Unë shpresoj se se ju do të ushtroni udhëheqjen e juaj politike që sa më shpejt të arrini ndonjë marrëveshje me autoritetet relevante të Beogradit ti siguroni ata që të gjithë individëve në Kosovë tu bëhet pagesa e pensioneve atyre që ju takon. Unë poashtu shpresoj se ju do të krijoni mënyra që këto pagesa të jenë nën kujdesin e administratës së përkohëshme civile.

Ndoshta nuk ka nevoj të thuhet ,unë jam në dispozicionin tuaj të diskutojmë këto çështje edhe më tutje. Do të jem mirënjohës për çdo gjë që të më informoni për ndonjë përparim rreth zgjidhjes së këtyre çështjeve shumë serioze.

Me nderime,

Marek Antoni Nowicki
Ombudspersoni**PËRGJEGJJA: Nuk është marrë asnjë përgjegje në këtë letër**

20 prill 2001

Z. Hans Hakerup
Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
Të Kombëve të Bashkuara
UNMIK

I nderuari Z. Hakerup,

Duke ju referuar letrës sime që jua kam derguar me 7 mars 2001 lidhur me vështirësitë që po përballën pensionerët shqiptarë për marrjen e pensioneve të tyre , do të isha i interesuar të di nëse keni mundur të bëni ndonjë zhvillim në këtë çështje të vështirë.

Unë ju kam bashkangjitur kopjën e letrës sime origjinale për informimin dhe bindjen e tuaj

Me nderime,

Marek Antoni Nowicki
Ombudspersoni

enc.

PËRGJEGJJA: Nuk është marrë asnjë përgjigje në këtë letër

21 maj 2001

Lord George Robertson
Sekretarit të Përgjithshëm
të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut
Blvd. Leopold III
1110 Bruksel
Belgjikë

e-mail: natodoc@hq.nato.int

I nderuari Lordi Robertson,

Që nga hapja e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë në fund të nëntorit të . 2000, unë kam takuar disa banorë të Kosovës anëtarët e familjeve të të cilëve janë vrarë gjatë aksioneve të NATO-s të vitit 1999, në incidentet që NATO i ka pranuar qysh atëherë se kanë qenë të gabuara (për shembull bombardimi i urës së Lluzhanit dhe postës qendrore në Prishtinë).

Njerëzit që kanë ardhë tek unë kanë pasur për qëllim gjetjen e kanaleve të duhura nderkombëtare përmes të cilave do të kërkonin dëmshperblim për humbjet e tyre ose nga ana tjetër ti adresojnë këto çështje përmes kësaj lidhje.

Deri tani, ata nuk kanë mundur të sigurojnë asnjë informacion se kujt mund ti adresohen ose se çfarë mekanizma procedural egzistojnë në mënyrë që të realizojnë një zgjidhje për vuajtjet e tyre. Asnjë Institucion në Kosovë apo gjetiu nuk ju ka përgjegjur çështjeve më themelore humanitare deri tani.

Meqëse unë jam në dijeni për faktin se nuk kam jurisdikcion formal ndaj NATO-s apo ndaj çdo vendi anëtarë të saj , unë shpresoj se ju do ta konsideroni pozitivisht këtë kërkesë, që NATO apo anëtarët e saj të sigurojnë disa mjete përmes të cilave, civilët të cilët kanë vuajtur humbje të tilla tragjike të kenë vemendje të duhur, duke përfshirë përgatitjen e një forme të kompenzimit.

Lidhur me këtë, Institucioni i Ombudspersonit në Kosovë është gati të shërbejë si pikë kontaktuese apo në çfarëdo mënyre tjetër të ngjajshme.

Unë u jam mirënjohës për kujdesin dhe konsideratën tuaj ndaj kësaj kërkesë dhe pres përgjegje pozitive nga ju .

Me nderime,

Marek Antoni Nowicki
Ombudsperson

cc: Ministrave të Jashtëm të vendeve anëtare të NATO-s
Z. Javier Solanës, Përfaqësuesit të Lartë të UE për Bashkupnim dhe Politikë të Jashtme
Z. Hans Hakerupit, Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombëve të Bashkuara

PËRGJEGJJA: Nuk është marrë asnjë përgjegje në këtë letër.

Aneksi 3

Rregullorja mbi Themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission in
Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies au
Kosovo

UNMIK

UNMIK/REG/2000/38
30 Qërshor 2000

RREGULLORJA NR 2000/38

MBI THEMELIMIN E INSTITUCIONIT TË OMBUDSPERSONIT NË KOSOVË

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimet që i janë dhënë atij me rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara nr. 1244 (1999) të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren nr. 1999/1 të datës 25 korrik 1999 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), të përmirësuar, me Autoritetin e Administratës së Përkohshme Civile,

Me qëllim të intensifikimit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Kosovë,

Me anë të këtij akti shpall, me sa vijon:

Neni 1 Themelimi i institucionit të Ombudspersonit në Kosovë

1.1 Ombudspersoni do t'i promovojë dhe mbrojë të drejtat dhe liritë e individëve dhe personave juridik dhe do të sigurojë se të gjithë personat në Kosovë të jenë në gjendje t'i ushtrojnë efektivisht të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të mbrojtura me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, në veçanti Konventa Evropiane mbi të drejtat e njeriut dhe Protokolet e saj si dhe Pakti ndërkombëtar mbi të drejtat civile dhe politike.

1.2. Ombudspersoni do të sigurojë mekanizma që do të jenë në dispozicion dhe që me kohë do të bëjnë rishqyrtimin dhe përmirësimin e veprimtarive të cilat krijojnë keqpërdorim të autorizimeve nga administrata e përkohshme civile apo të çdo institucioni qëndror ose lokal që do të shfaqet.

Neni 2 Natyra e institucionit të Ombudspersonit

2.1 Ombudspersoni do të veprë pavarësisht. Asnjë person qoftë fizik apo juridik nuk do të ndërhyjë mbi ushtrimin e detyrave të tij apo të saj.

2.2. Shërbimet e ofruara nga Ombudspersoni do të jenë pa pagesë.

Neni 3: Kompetenca

3.1 Ombudspersoni do të ketë kompetencë për pranimin dhe hetimin e ankesave nga çdo individ apo person juridik në Kosovë sa i përket shkeljeve të drejtave të njeriut dhe veprimtarive që përbëjnë keqpërdorim të autorizimeve nga administrata e përkohshme civile apo të çdo institucioni qëndror ose lokal që do të krijohet. Ombudspersoni duhet dhënë prioritet të veçantë pohimeve mbi shkeljet e ashpra ose sistematike si dhe atyre të bazuara në diskriminim. Në këtë nen, ‘veprimtaritë’ përfshijnë veprimet, mosveprimet dhe vendimet.

3.2 Kompetenca e Ombudspersonit do të zgjerohet në tërë territorin e Kosovës. Ombudspersoni mund të ofrojë shërbimet e tij sa i përket rasteve që kanë të bëjnë me Kosovarët jashtë territorit të Kosovës.

3.3 Ombudspersoni do të ketë kompetencë mbi të gjitha rastet që ndodhin pas ardhjes në fuqi të kësaj rregulloreje poashtu edhe rasteve që rrjedhin nga faktet që kanë ndodhur para kësaj date, por që këto fakte ende shkaktojnë shkelje të vazhdueshme të një apo me shumë të drejtave të njeriut.

3.4 Me qëllim që të mirret me raste që kanë të bëjnë me forcat paqëruajtëse të Kosovës, Ombudspersoni mund të hyjë në marrëveshje me Komandantin e Forcave të Kosovës (KOMKFOR).

3.5 Ombudspersoni nuk do të ketë kompetencë që të mirret me mosmarrëveshje midis administratës ndërkombëtare dhe stafit të tij/saj.

Neni 4: Veprimtaritë dhe autorizimet

4.1 Ombudspersoni mund të pranojë ankesa, mbikqyrë, hetojë, të ofrojë shërbimet e tij/saj, të ndërmarrë hapa preventiv, të bëjë rekomandime dhe të këshillojë në çështjet lidhur me veprimtaritë e tij/saj.

4.2 Ombudspersoni mund të promovojë pajtimin ndërmjet grupeve etnike.

4.3 Përpos siç është paraparë në nenin 2 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/24 të datës 12 dhjetor 1999 mbi Ligjin e zbatueshëm në Kosovë, Ombudspersoni mund të ofrojë këshilla dhe të bëjë rekomandime tek çdo individ apo person juridik sa i përket pajtueshmërisë midis ligjeve vendase dhe rregulloreve me standardet e njohura ndërkombëtare.

4.4 Ombudspersoni do të ketë kompetencë t’i kryejë hetimet, si përgjigje ndaj ankesës së bërë, siq është paraparë me nenin 3.1, ose sipas vetiniciativës.

4.5 Ombudspersoni do t’i ndërmerrë të gjithë hapat dhe veprimet e domosdoshme për t’i shqyrtuar keto ankesa të bëra nën nenin 3.1, duke e përfshirë këtu edhe intervenimin e drejtëpërdrejtë tek autoritetet përkatëse, të cilëve do t’u kërkohet të përgjigjen, brenda një afati të arsyeshëm kohor.

4.6 Kur, gjatë kryerjes së hetimit, Ombudspersoni vlerëson se ekzekutimi i vendimit administrativ mund të rezultojë me pasoja të pandreqshme mbi të drejtën e ankuesit ai/ajo mund të rekomandojë te organet përkatëse të suspendojnë ekzekutimin e atij vendimi.

4.7 Ombudspersoni do të ketë të drejtë dhe do të mund të shqyrtojë dosjet dhe dokumentet e Administratës së përkohshme civile dhe të çdo institucioni qëndror apo lokal që do të krijohet, dhe në pajtim me këtë rregullore, mund të kërkojë nga çdo person të bashkëpunojë duke siguruar atij/ asaj informata përkatëse, dokumente dhe dosje. Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm megjithatë mund të kundërshtojë dhënjën e dosjeve apo dokumenteve, të siguruara ashtu që Ombudspersonit i ipen arsyetimet me shkrim. Në raste të këtilla, Ombudspersoni mund të nxjerrë konkludime të atilla siq i përshtaten atij/ asaj, nga refuzimi.

4.8 Ombudspersoni në çdo kohë mund të hyjë dhe të inspektojë çdo lokalitet në të cilin individët janë të privuar nga liria dhe mund të jetë prezent në mbledhje apo seanca që kanë të bëjnë me këta persona. Ombudspersoni mundet gjithashtu të mbajë mbledhje private me këta persona.

4.9 Gjatë apo duke përcjellur hetimet, Ombudspersoni mund të bëjë rekomandime te organet përkatëse administrative dhe tek zyrtarët ashtu që të bëhet miratimi i masave përkatëse, duke përfshirë edhe masa të përkohshme sipas nevojës.

4.10. Gjatë përcjelljes së hetimeve, Ombudspersoni mund t'u rekomandojë organeve kompetente që të hapin procedurat penale dhe dicitinore kundër çdo personi.

4.11. Nëse, përkundër nxjerrjes së rekomandimeve nga Ombudspersoni, zyrtarët apo organet e caktuara administrative nuk marrin masa të caktuara brenda një aftati të arsyeshëm kohor, apo nuk i sigurojnë Ombudspersonit arsyet për se nuk është vepruar, që janë të pranueshme për të, Ombudspersoni mund të tërheq vëmendjen tek Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm për këtë çështje dhe pastaj të jap deklaratë publike.

4.12. Ombudspersoni do t'i publikojë rekomandimet e tij/saj, përpos në rastet kur ai/ ajo konsideron që kanë të bëjnë me çështje konfidenciale ose sekrete, apo kur personi që ka paraqitur ankesën, shprehimisht ka kërkuar që identiteti i tij/saj dhe rrethanat e ankesës të mos zbulohen.

4.13. Vendimet ose veprimet e ndërmarra nga ana e Ombudspersonit nuk mund të goditen me kurrfarë ankese.

Neni 5: Përbërja e Institucionit të Ombudspersonit

Zyra e Ombudspersonit do të përbëhet prej Ombudspersonit, më së paku prej tre (3) zëvendëve të tij dhe personelit kompetent profesional.

Neni 6: Ombudspersoni

6.1. Ombudspersoni do të jetë një figurë e shquar me karakter të lartë moral, i paanshëm dhe i ndershëm, dhe që zotëron një angazhim të vërtetë për të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve dhe që nuk është shtetas i Republikës Federale të Jugosllavisë, ndonjë shteti që ka qenë pjesë e Jugosllavisë së mëparshme ose shtetas i Shqipërisë.

6.2. Ombudspersoni do të emërohet nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm për një periudhë dy vjeçare. Riemërimi mund të bëhet pastaj për periudhë dy vjeçare.

Neni 7: Zëvendësit e Ombudspersonit

7.1. Sipas propozimeve të Ombudspersonit të përcjellura me konsultime në nivel lokal dhe ndërkombëtar, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm do të emërojë së paku një zëvendës ndërkombëtar dhe dy zëvendës vendas të Ombudspersonit, të cilët do të jenë figura të shquara me karakter të lartë moral, të paanshëm dhe të ndershëm, dhe që zotërojnë një angazhim të vërtetë për të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve.

7.2. Ombudspersoni, siq ai/ajo e sheh të përshtatshme, mund të delegojë te Zëvendësit e tij çdo funksion apo autorizim të dhënë sipas nenit 4 të kësaj rregulloreje.

Neni 8: Papajtueshmëritë dhe largimi nga detyra

8.1. Pozita e Ombudspersonit dhe zëvendësve të tij, si dhe personelit të institucionit të Ombudspersonit, është e papajtueshme me çdo aktivitet politik, publik, dhe me ushtrimin e detyrave ose veprimtarisë private profesionale.

8.2. Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të pushojë nga detyra Ombudspersonin dhe/ose zëvendësit e tij/saj, kur Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm konsideron se janë krijuar një apo më shumë baza siq vijojnë, përkritazi me Ombudspersonin dhe/ose të Zëvendësve të Ombudspersonit:

- (a) paaftësisë fizike ose mendore që ndikojnë në aftësitë e tij/saj për kryerje e funksionit të tij/saj;
- (b) dënimin e plotëfuqishëm për veprën penale, të dënueshme me privim lirie;
- (c) dështim në kryerjen e detyrave të tij/saj; apo
- (d) të caktimit, me sjellje personale ose në mënyrë tjetër, në pozitë e cila është e papajtueshme me ekzekutimin e drejtë të detyrave.

8.3. Ombudspersoni mund të kërkojë nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, që të pushojë njërin apo më tepër nga zëvendësit e tij/saj nga detyra për një apo më tepër shkaqe të cilat u çekën më lartë. Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm do të merr vendimin përfundimtar sa i përket shkarkimit nga detyra.

8.4 Në rast të pushimit nga detyra të Ombudspersonit apo të Zëvendësit(ve) në pajtim me nenin 8.2, apo në rast vdekjeje apo dorëheqjeje të Ombudspersonit apo të Zëvendësve të tij/saj, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të emërojë Ombudsperson të ri dhe/apo Zëvendës të ri të tij/saj sa më shpejt që është e mundur në pajtim me rregulloren e tanishme.

Neni 9: Personeli

Personeli i institucionit të Ombudspersonit do të përbëhet prej personave vendës dhe ndërkombëtarë që zotërojnë standarde të larta të efikasitetit, që janë të ndershëm dhe kompetent.

Neni 10: Rregullat e procedurës

Ombudspersoni, pas konsultimeve me Zëvendësit e tij/saj, do të miratojë rregullat e procedurës të institucionit të Ombudspersonit.

Neni 11: Mirëbesimi

Ombudspersoni do të mbajë në mirëbesim të gjitha informatat konfidenciale dhe të dhënat e pranuar, duke i kushtuar vëmendje të posaqme sigurisë së ankuesve dhe dëshmitarëve.

Neni 12: Bashkëpunimi

12.1 Të gjithë individët dhe personat juridik që janë nën kompetencat e Ombudspersonit janë të obliguar t'i sigurojnë Ombudspersonit bashkëpunimin e kërkuar.

12.2. Ombudspersoni mund të bashkëpunojë dhe koordinojë me Ombudspersona të tjerë ndërkombëtarë si dhe institucione që merren me mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Neni 13: Privilegjet dhe imuniteti

13.1 Ombudspersoni, Zëvendësit ndërkombëtarë të Ombudspersonit si dhe personeli ndërkombëtarë dhe lokal do të gëzojnë imunitet nga procedurat juridike sa i përket mendimit të shprehur dhe të shkruar dhe veprimet e ndërmarra nga ta, përgjatë kryerjes së detyrave të tij. Edhe pasi të pushonë së kryeri detyre për institucionin e Ombudspersonit ata do të gëzojnë imunitet të tillë. Ombudspersoni dhe Zëvendësit e Ombudspersonit do të gëzojnë vlejë edhe lehtësira tjera të domosdoshme për ushtrimin e pavarur të detyrave të tyre.

13.2. Ombudspersoni, Zëvendësit ndërkombëtarë dhe personeli ndërkombëtar i institucionit të Ombudspersonit, do të gëzojnë imunitet dhe privilegje të zyrtarëve të Kombeve të Bashkuara, të paraparë me nenin V të Konventës mbi Privilegjet dhe Imunitetet e Kombeve të Bashkuara. Zëvendësit vendas të Ombudspersonit dhe personeli i rekrutuar vendas do të gëzojnë imunitet sa i përket veprimtarisë zyrtare dhe përjashtime nga obligimet tatimore dhe shërbimeve vendase të parapara me Nenin 18(a), (b) dhe (c) në Konventën e lart-përmendur.

13.3 Në rregulloren e tanishme asgjë nuk do të interpretohet si pakësim i privilegjeve dhe imuniteteve që u janë akorduar UNMIK-ut dhe zyrtarëve të tij sipas Konventës së lart-përmendur.

Neni 14: Pacenueshmëria dhe paprekshmëria e objekteve, mjeteve të komunikimit, arkivës, dosjeve dhe dokumenteve

14.1. Objektet e Ombudspersonit do të jenë të pacenueshme. Organet kompetente duhet të ndërmarrin veprime të ndryshme, të domosdoshme që të sigurojnë Ombudspersonin se nuk do t'i merret ndonje pjesë ose i tërë objekti, pa e shprehur pëlqimin e tij. Arkiva, dokumentet, mjetet e komunikimit, prona, fondet dhe aktiva e Ombudspersonit kudo që janë të vendosura dhe nga kushdo që mbahen do të jenë të pacenueshme dhe të paprekshme nga çdo kontrollim, kapje, kërkesë, konfiskim, shpronësim ose çdo formë tjetër e ndërhyrjes me çfarëdo veprimi juridik, ekzekutiv, administrativ ose legjislativ.

14.2 Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të jetë i vetmi organ i cili do të pushojë të drejtën e pacenueshmërisë dhe paprekshmërisë së lartpërmendur.

Neni 15: Zyra e Ombudspersonit

15.1 Institucioni i Ombudspersonit do të ketë selinë e vet në Prishtinë. Poashtu do të ketë edhe zyra rajonale sipas nevojës.

15.2. Në pajtim me nenin 18 të rregullores së tanishme, institucionit të Ombudspersonit do t'u sigurohen objekte përkatëse.

Neni 16: Gjuhët që do të përdoren gjatë punës

Gjuhët që do të përdoren gjatë kryerjes së detyrave do të jenë gjuha angleze, shqipe dhe ajo serbe.

Neni 17: Raportet

17.1 Ombudspersoni do t'i paraqesë Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm raportet vjetore dhe përfundimet e tij/saj do t'i publikojë.

17.2 Ombudspersoni mund të leshojë raporte speciale sadoherë që e konsideron të nevojshme.

Neni 18: Financimi

Për vitin 2000, Institucioni i Ombudspersonit do të financohet nga donatorët ndërkombëtarë. Në vitet vijuese fiskale, Ombudspersoni mund të kërkojë fonde nga donatorët ndërkombëtarë dhe/ose nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës për veprimtarinë e institucionit.

Neni 19: Periudha e implementimit

Institucioni i Ombudspersonit do t'i ushtrojë detyrat e tij/saj dhe do të hapet për palë, jo më vonë se gjashtë (6) muaj pas emërimit të Ombudspersonit.

Neni 20: Vazhdimësia e aktivitetit

Përgjegjësia për vazhdimësinë e aktivitetit të institucionit të Ombudspersonit mund të transferohet deri te organet e zgjedhura të Kosovës, pasi të themelohen.

Neni 21: Ligji i Zbatueshëm

Rregullorja e tanishme zëvendëson çdo klauzolë në ligjin e zbatueshëm lidhur me themelimin apo aktivitetin e institucionit të Ombudspersonit që është i papajtueshëm me të.

Neni 22: Hyrja në fuqi

Rregullorja e tanishme do të hyjë në fuqi më 30 korrik 2000

Bernard Kouchner
Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm

Aneksi 4**Rregullat Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë****HYRJA**

Ombudspersoni,

Në pajtim me autorizimet e dhëna në Rregullorën e UNMIK-ut nr.2000/38, të datës 30 Qershor 2000 mbi Krijimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, neni 10, dhe,

Duke u thirrur në:

- Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara nr. 1244 (1999) të datës 10 qershor 1999, në veçanti paragrafi 11,
- Raportin e Sekretarit të Përgjithshëm mbi Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë të 12 korrikut 1999 (S/1999/779) dhe në veçanti paragrafi 89-90, dhe
- Vendimin e OSBE-së nr. 305 të 1 korrikut 1999(PC.DE/305) në veçanti paragrafi 4,
- Raportin e Sekretarit të Përgjithshëm mbi Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë të 23 dhjetorit 1999 (S/1999/1250), në veçanti paragrafi 83.

Miraton këto rregulla procedurale:

DISPOZITAT HYRËSE

E drejta për tu ankuar te Ombudspersoni ndaj shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe ndaj keqpërdorimeve të autoritetit, u garantohet të gjithë personave pa marrë parasysh origjinën, nënshtetësin, përkatësin etnike, nacionalitetin, gjinin, racën, ngjyrën, gjuhën, religjionin, mendimet politike, origjinën sociale ose nacionale, lidhshmërin me minoritetet nacionale, pronën, lindjen, moshën, orientimin seksual, vendbanimin, mungesën e zotësisë juridike, parburgimin, raportin me çfarëdo autoriteti administrativ ose me ndonjë status tjetër. Të gjitha shërbimet që ofrohen nga Institucioni i Ombudspersonit janë falas.

Definicionet

Termet e numëruara si vijon do të nënkuptohet se kanë këtë kuptim:

1. Parashtruesi i kërkesës: çdo individ, grup i individëve, organizata jo qeveritare të regjistruara apo të pa regjistruara, ose entiteti që ankohet që të drejtat e tij janë shkelur ose dëshmojnë se janë viktimë e keqpërdorimit të autoritetit
2. Kërkesa: Një formë e kompletuar që paraqet një ankesë mbi shkeljen e të drejtave të njeriut dhe keqpërdorimin e autoritetit të cilës Ombudspersoni duhet ti përgjigjet.
3. Regjistrimi i përkohshëm: procesi numerik i regjistrimit të kërkesave të pranuar nga Ombudspersoni.
4. Regjistrimi: Procesi numerik i regjistrimit të kërkesave që janë verifikuar të pranueshme nga Ombudspersoni.
5. Pala përgjegjëse: Secili person ose etnitet i përcaktuar sipas rregullorës kundër të cilit është parashtruar kërkesa te Ombudspersoni ose kënd Ombudspersoni e identifikon ex- officio që ka pasur një rol të mundshëm në shkeljen ose keqpërdorimin e pohuar.
6. Palët: Parashtruesi i kërkesës dhe pala përgjegjëse/palët.
7. Autoriteti tjetër: cilido autoritet/entitet/grup tjetër, përveç palës përgjegjëse, i cili gjatë hetimeve, në çfardo mënyrë të jetë i përzier në këtë çështje para Institucionit të Ombudspersonit.
8. Përfaqësuesi: secili person i autorizuar nga viktima ose me ligj për përfaqësimin e atij në procedurat para Institucionit të Ombudspersonit.

Rregulla 1**Plotësimi i kërkesës**

1. Parashtruesi i kërkesës duhet ta plotësojë një kërkesë të siguar nga Institucioni i Ombudspersonit më ndihmen e një nënpunësi të Institucionit të Ombudspersonit. Kërkesa duhet të ketë datën dhe nënshkrimin e parashtruesit të kërkesës ose përfaqësuesit të tij.
2. Prezantimi ligjor përmes avokatit nuk është i nevojshëm.
3. Kërkesa duhet të përmbaj këto informata.
 - a) emëri i plotë, mosha, gjinia, përkatsia etnike, profesioni, gjendja martesore dhe nënshtrësia e parashtruesit të kërkesës, emëri i plotë dhe informatat mbi regjistrimin, nese është regjistruar, i çdo parashtruesi të kërkesës nese është një organizatë ose entitet.
 - b) adresa e shtëpisë ose profesionale e viktimës /parashtruesit të kërkesës, adresa postale nëse është tjetër.
 - c) emri i plotë/, profesioni dhe adresa kontaktuese e përfaqësuesit të parashtruesit të kërkesës nese ka ndonjë.
 - d) emri i plotë/titulli dhe adresa kontaktuese e palës së përgjegjëse apo palëve të njohura nga parashtruesi i kërkesës e nëse nuk janë të njohura atëherë informata të mjaftueshme për identifikimin e palës përgjegjëse apo palëve.
 - e) emrin e plotë të nënpunsit të Institucionit të Ombudspersonit që e ndihmon parashtruesin e kërkesës.
 - f) deklaratën lidhur më pretendimet e pohuara, duke përfshirë datën e incidentit.
 - g) deklaratën e pohimeve për shkeljen e të drejtave të njeriut apo për keqpërdorimin e autoritetit.
 - h) deklaraten se çka dëshiron të arrijë parashtruesi i kërkesës në atë rast specifik,
 - i) listën e dokumenteve të bashkangjitura kërkesës, dhe në qoftë se parashtruesi i kërkesës nuk i ka ato dokumente, informatat se ku mund të gjinden ato dokumente të nevojshme.
 - j) indikacionin se a i është dorëzuar kërkesa e ngjashme ndonjë autoriteti vendor, ose ndonjë organi të Administratës së Përkohshme Civile, apo cilido organ ndërkombëtar dhe rezultatet e procedurave të tilla.
 - k) një koment i përgjithshëm paraprak nga nënpunsi që e ndihmon parashtruesin e kërkesës për çështjen nga ana e hetuesit duke përfshirë klasifikimin e përkohshëm të shkeljes së drejtave të njeriut
4. Autorizimi i përfaqësuesit duhet ti bashkangjitet kërkesës në qoftë se parashtruesi i kërkesës parashtron ankesën përmes përfaqësuesit ose nëse parashtruesi i kërkesës dëshiron të përfaqësohet gjatë çdo shkalle të procedurës para Ombudspersonit.
5. Formulari –kërkesa mund të plotësohet në cilindo gjuhë që përdoret në rajon ose në gjuhën angleze. Të gjitha konkluzionet apo vlersimet e kërkesës do të jenë në disponim në gjuhën angleze, shqipe, dhe serbe dhe ndonjë gjuhë tjetër, nëse Ombudspersoni vendos ashtu.
6. Parashtruesi i kërkesës ose përfaqësuesi i tij duhet të informojë Ombudspersonin në rast të ndërrimit të adresës ose lidhur me ndryshimin e ndonjë rrethane që është e rëndësishme për kërkesën.

Rregulla 2

Hetimet ex officio

Ombudspersoni mund të ndërmerret hetime me iniciativën e tij kur egzistojnë indicie për shkeljet e të drejtave të njeriut ose keqpërdorimin e autoritetit. Kur vendos për hapjen e një hetimi ex-officio, Ombudspersoni mund të pranojë informata nga çdo burim.

Rregulla 3

Regjistrimi i përkohshëm dhe njoftimi për pranimin e kërkesës

1. Ombudspersoni duhet ti regjistroj përkohësisht të gjitha kërkesat e pranuar.
2. Ombudspersoni duhet ta njoftoj parashtruesin e kërkesës për pranimin e kërkesës sa më shpejtë që është e mundur.

Rregulla 4

Konfidencialiteti dhe dokumentet konfidenciale

1. Gjatë pranimit të kërkesës, parashtruesin e kërkesës apo përfaqësuesin e tij do ti pyësim nëse dëshirojnë që emri i tij të mbahet sekret.
2. Të gjithë punëtorët e Institucionit të Ombudspersonit që kanë çasje në informata dhe dokumente konfidenciale janë të obliguar që këto informata të mos i japin në publik dhe as autoritete.
3. Të gjitha dokumentet e mbledhura gjatë hetimeve të çështjeve ku diskrecioni është kërkuar nga parashtruesi i kërkesës, ose është vendosur nga Ombudspersoni, do të regjistrohen si konfidenciale, sipas kërkesës së parashtruesit të kërkesës ose iniciatives së vet Ombudspersonit.

4. Të gjitha dokumentet konfidenciale do të ruhen në kabinete speciale të siguruara.
5. Çasja në dokumentet konfidenciale do të kufizohet në hetues të cilët direkt janë të caktuar të merren më çështjen konkrete dhe në Drejtorin e Hetimeve. Çasja e punëtorëve të tjerë në këto dokumente mund të lejohet vetëm atëherë kur autorizohet nga vetë Ombudspersoni.

Rregulla 5

Kushtet për pranueshmëri

1. Ombudspersoni duhet të verifikoj pranueshmërin e kërkesës.
2. Ombudspersoni nuk mund ta konsideroj si të pranueshëm kërkesën, nëse kërkesa:
 - a) nuk bie nën juridikcionin e Ombudspersonit në pajtim me dispozitën e nenit 3 të Rregullorës nr.2000/38 të 30 qershorit të vitit 2000.
 - b) Në mënyre evidente është e pabazuar, apo përmban keqpërdorim të drejtës për paraqitjen e kërkesës;
 - c) nuk është paraqitur para autoriteteve kompetente në Kosovë dhe egzistojnë baza të arsyeshme të besohet se një autoritet i tillë do të ofrojë mjete juridike efektive;
 - d) dosja është bërë nga ndonjë administratore ose ndonjë autoritet që ka lidhje me juridikcionin e autoritetit të njëjtë.
3. Ombudspersoni mundet, duke shfrytëzuar të drejten e tij diskrecionale të heq dorë nga cilado prej kushteve të përmendura më lartë, përveç kushtit 2a.
4. Në mënyrë që të vërtetohet pranueshmëria e kërkesës, Ombudspersoni mund të zhvilloj intervistime apo hulumtime të nevojshme.

Rregulla 6

Hapja e çështjes

1. Pasi që pranueshmëria është vërtetuar, Ombudspersoni do të haphetimin e çështjes.
2. Duke përcjellur këtë vendim, çështja duhet të regjistrohet.

Rregulla 7

Informimi i parashtruesit të kërkesës rreth vendimit të Ombudspersonit

1. Kur Ombudspersoni vendos se një kërkesë është e papranueshme, ai duhet ta njoftoj parashtruesin e kërkesës mbi bazat për atë vendim. Kur është e nevojshme, Ombudspersoni do ta njoftoj parashtruesin e kërkesës për mundësin e ushtrimit të një kërkesë të re ose përmirsimin e asaj që ishte më parë, për shembull, për sigurimin e informatave të reja, të përdoren mjete tjera juridike ose mjete të cilat bien jashtë juridikcionit të Ombudspersonit.
2. Nëse është vendosur se kërkesa është e pranueshme, Ombudspersoni duhet ta njoftoj parashtruesin e kërkesës.

Rregulla 8

Regjistrimi i hetimeve Ex Officio

Kur Ombudspersoni vendos të zhvilloj hetimet me iniciativën e tij ai do të bëj një vendim me shkrim duke përfshir bazat për atë vendim dhe kjo do të regjistrohet si bazë për zhvillimin e hetimeve.

Rregulla 9

Vendimi për fshirjen e rastit

1. Ombudspersoni mund të ndërprejë hetimet e çështjes nëse cilado prej rrethanave të parashikuara në Rregullën 5 janë prezente.
2. Ombudspersoni mund të ndërpres hetimin me kërkesën e parashtruesit të kërkesës.
3. Nëse Ombudspersoni vendos të ndërprej hetimin ai do ta njoftoj parashtruesin e kërkesës për këtë vendim dhe bazat e ndërprerjes. Në rastet e tilla, Ombudspersoni do ta fshijë çështjen nga lista e çështjeve që presin.

4. Ombudspersoni do ta njoftojë parashtruesin e kërkesës për mundësin e rihapjes së rastit, nëse arsyet për fshirjen e rastit nuk egzistojnë më dhe dëshmi të reja i paraqiten Ombudspersonit që e arsyetojnë hapjen e hetimeve të çështjes.

Rregulla 10

Informimi palëve /palës përgjegjese

1. Ombudspersoni mund të informoj palën përgjegjese /palët sa më shpejt që është e mundur lidhur me kërkesën dhe ti ftoj palët /palën përgjegjese ti dorëzojnë informacionet me shkrim, vështrimet dhe zgjidhjet e parashikuara. Nga palët / pala përgjegjese mund të kërkohet edhe dorëzimi i dokumenteve specifike.
2. Ombudspersoni cakton një afat sipas së cilit pala përgjegjese/palët mund të ankohen më kërkesë të Ombudspersonit.
3. Nëse palët / pala përgjegje nuk përgjigjen, Ombudspersoni mund të ndjek hetimet duke u bazuar në informata të tjera me të cilat disponon.
4. Ombudspersoni në disa raste mund të vendos për fillimin e hetimeve pa kërkuar informata, vështrime apo zgjidhje të parashikuara nga palët/ pala përgjegjëse.

Rregulla 11

Autoritetet tjera

1. Nëse hetimet indikojnë se edhe ndonjë autoritet tjetër përveç palës / palëve përgjegjëse, është i përzier në çështjen në fjalë, atëherë Ombudspersoni në çdo kohë gjatë hetimeve mund të kontaktojë me autoritetet përkatëse.
2. Ombudspersoni mund të vendos për kualifikimin e autoritetit përkatës si palë /palë përgjegjëse dhe të zhvilloj procedurën e sipërpërmendur.

Rregulla 12

Informimi i parashtruesit të kërkesës për parashtrësar e palës përgjegjëse

1. Ombudspersoni mund ta informoj parashtruesin e kërkesës lidhur me parashtrësar e palëve / palës përgjegjëse dhe do ti jap mundësi parashtruesit të kërkesës ti përgjigjet çështjeve të ngritura në parashtrësar e palës përgjegjese.
2. Ombudspersoni mund të kërkoj prej parashtruesit të kërkesës që të përgjigjet brenda afatit të caktuar nga Ombudspersoni.
3. Nëse parashtruesi i kërkesës dështon që të përgjigjet, Ombudspersoni mund të filloj hetimet. Por, dështimi për tu përgjigjur mund të konsiderohet si humbje e interesimit dhe mund të arsyetoj ndërprerjen e hetimit.

Rregulla 13

Hetimet dhe ndihma prioritare

1. Në çdo kohë gjatë hetimeve, Ombudspersoni mund të intervistoj dëshmitarët.
2. Nëse punëtorët administrativ refuzojnë ose janë të penguar për tu intervistuar nga Ombudspersoni, ai mund të kërkoj sqarim me shkrim dhe tu adresohet në mënyrë hierarkike personave përgjegjes.
3. Të gjithë personat dhe enitetet që janë nën juridikcionin e Ombudspersonit kërkohet që ti ofrojnë ndihmë prioritare Ombudspersonit. Gjithëashtu personeli që punon në emer të Ombudspersonit mund të përfitojë nga kjo ndihmë prioritare.
4. Ombudspersoni mund të kërkoj ndihmë nga policia dhe KFORI nëse është e nevojshme për të siguruar hetimet dhe ti mbroj parashtruesit e kërkesave, dëshmitarët ose çdo person tjetër të cilët janë perziër në hetimet nga Ombudspersoni, duke përfshirë vetë Ombudspersonin dhe personelin e Institucionit.
5. Nëse ndihma prioritare nuk ofrohet, Ombudspersoni mund ti lajmëroj autoritetet më të larta kompetente lidhur me këtë çështje.

Rregulla 14

Çasje në dosje, dokumente dhe inspektimet

1. Në çdo kohë gjatë hetimeve Ombudspersoni nga individët, autoritetet qeveritare apo personat juridik mund të kërkoj bashkëpunim për dhënien e informatave relevante, dokumenteve dhe dosjeve duke përfshirë edhe ato të kategorizuara si sekrete ose konfidenciale . Ata duhet të sigurojnë të gjitha informatat dhe ndihmën e kërkuar nga Ombudspersoni.
2. Në mënyrë që të mos pengohet çasja e tij në dokumentacion, Ombudspersoni mund të zhvilloj inspekcione efektive rutinore ndaj cilitdo autoritet nën juridiksionin e tij.
3. Të gjitha autoritetet nën juridiksionin e Ombudspersonit janë të detyruera ti lejojnë Ombudspersonit çasjen në objektet e tyre, duke lejuar atyre lëvizjen brenda objektit pa kufizime për të kërkuar dokumente, ti intervistojnë dëshmitarët ose të ndërmarrin ndonjë aktivitet tjetër të rëndësishëm për hetimin.
4. Ombudspersoni mund të kërkoj kopjet e cilit do dokument të sipërpërmendur që do të sigurohen nga autoritetet relevante ose agjensitë.
5. Nëse punëtorët administrativ refuzojnë apo janë të pënguar që të japin informata për dokumentet apo dosjet, Ombudspersoni mund të kërkoj sqarim më shkrim dhe mund të adresoj çështjen në mënyrë hierarkike.
6. Nëse Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm përdorë të drejtën e tij që refuzon lëshimin e dokumentit apo dosjes , siç është paraparë në nenin 4.7 të Rregullorës nr. 2000/38, Ombudspersoni mund të verej këto refuzime dhe të adresoj refuzimin e tillë në raportin special apo atë vjetor të tij.
7. Kur kërkohet, Ombudspersoni dhe punëtorët e tij do të ndërmarin detyra konfidenciale me respekt ndaj dokumenteve apo informatave konfidenciale. Ky obligimi duhet të vazhdoj edhe mbasi që personi përkatës lëshon zyren ose ndërpret punën në Ombudsperson.
8. Ombudspersoni, mundet në çdo kohë të hyjë dhe të kontrolloj çfarëdo vendi ku njerëzve iu është privuar liria ose ku liria e lëvizjes është kufizuar (p.sh. qendat e paraburgimit, burgjet policore, spitalet psikiatrike etj).
9. Ombudspersoni mundet që pa prezencën e autoriteteve të intervistoj personat e privuar nga liria dhe të marrë pjesë në çdo mbledhje apo dëgjim ku përfshihen persona të tillë.

Rregulla 15

Ndihma Ombudspersonit

Ombudspersoni në çdo fazë të hetimeve paraprake apo të tjera mund të ndihmohet nga çdo person që konsiderohet si i domosdoshëm, si parashtruesi i kërkesës, palët /pala e përgjegjëse dhe përfaqësuesit e tyre, interpretët dhe ekspertët ligjor, gjyqësor, të financave etj.

Rregulla 16

Masat e përkohshme dhe pezullimi i vendimeve administrative

1. Në çdo kohë gjatë hetimeve Ombudspersoni mund ti rekomandoj palëve/ palës përgjegjëse apo ndonjë autoritet tjetër të miratoj çfarido mase të përkohshme që ai i konsideron si të domosdoshme për mbrojtjen e menjëhershme të të drejtave dhe lirive të parashtruesit të kërkesës apo për sigurinë e tij dhe të dëshmitarëve.
2. Gjatë një hetimi Ombudspersoni mund ti rekomandoj palës përgjegjëse/palëve të pezullojnë egzekutimin e një vendimi administrativ ose dicitinor, nese një egzekutim i tillë mund te shkaktojë dëm të pa përmirësueshëm për të drejtat e parashtruesit të kërkesës.
3. Ombudspersoni mund të kërkoj nga autoritetet përgjegjëse ti zbatojë masat e përkohshme të kërkuara dhe të caktojnë një afat sipas se cilit pala përgjegjëse/palët mund ti paraqesin kërkesë Ombudspersonit.
4. Masat e përkohshme të ndërmarra në pajtim me paragrafin 1. dhe 2. do të jenë në fuqi derisa të përfundojnë hetimet ose deri atëherë kur Ombudspersoni të vendos për përfundimin e tyre.
5. Ombudspersoni do ti informoje palët e tjera për rekomandimet të aprovuara sipas paragrafin 1. dhe 2. për përgjegjësin e autoriteteve të cilave iu është adresuar rekomandimi.

Rregulla 17

Shërbimet e mira

1. Ombudspersoni mundet në çdo fazë gjatë hetimit të ofrojë shërbime të mira p.sh. ndërmjetsimin dhe pajtimin dhe ti jap shërbimet e veta në dispozicion të palëve në mënyrë që të siguroj zgjedhjen miqësore të çështjes në baza të respektimit të drejtave të njeriut të definuara me standardet e pranuar ndërkombëtare.
2. Kur të arrihet zgjidhja miqësore, obligimet e ndërmarra nga palët, afati për përmbushjen e tyre dhe rrethanat tjera relevante për rastin do të jenë të përfshira në marrëveshjen e shkruar.
3. Ombudspersoni do të përfundoj hetimet dhe të mbyllë rastin kur ai konsideron që palët kanë përmbushur zotimet e tyre të ndërmarra me marrëveshjen e shkruar si pjesë e zgjidhjes miqësore.
4. Ombudspersoni mund poashtu të ofroj shërbimet e tij në rastet kur përfshihen personat nga Kosova që janë jashtë territorit të saj.

Rregulla 18

Raportimi i çështjes

Atëhere kur hetimet janë kryer, Ombudspersoni duhet të bëjë një raport mbi çështjen, kjo përfshin edhe rekomandimet nese ka ndonjë.

Rregulla 19

Rekomandimet

1. Nëse Ombudspersoni gjen çfardo shkelje ose keqpërdorim të autoritetit që vjen nga neni 1 dhe 3 i Rregullorës nr. 20000/38 ai do të bëjë rekomandime palëve/palës përgjegjëse me qëllim që ata të marrin masa adekuate, dhe të caktojë afatin për përmbushjen e tyre. Afati mund të vazhdohet nëse Ombudspersoni konsideron se është e domosdoshme.
2. Ombudspersoni mund t'ju rekomandoj autoriteteve kompetente që procedurat penale dhe disiplinore të inicohën kundër çdo personi.
3. Nëse Ombudspersoni gjen se autoriteti tjetër përveç palëve/ palës përgjegjëse ka kontribuar indirekt në shkelje, ai mund të rekomandoj që autoritetet përkatëse të miratojnë masa të domosdoshme dhe adekuate.
4. Ombudspersoni do të njoftojë parashtruesin e kërkesës për rekomandimet e tij dhe për përgjigjen e palëve /palës përgjegjëse ose të autoriteteve tjera të përfshira në çështje.
5. Ombudspersoni mund të bëjë rekomandime të ndryshojë legjislacionin egzistues vendor ose të aprovoj legjislacionin e ri në mënyrë që të siguroj pajtushmëri të sistemit ligjor me standardet e pranuar ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Rregulla 20

Monitorimi / Mbyllja e rastit

1. Kur Ombudspersoni i bën rekomandimet ndërsa autoritetet administrative ose zyrtare të caktuera nuk ndërmarrin masa të duhura mbrenda një kohe të arsyeshme, ose nese nuk i tregojnë Ombudspersonit arsyet për mos ndërmarrjen e masave të tilla që janë të pranueshme nga Ombudspersoni, ai mund të tërheq vëmendjen e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për çështjen dhe mund ta bëjë publike deklaratën.
2. Kur Ombudspersoni ka vendosur që perioda monitoruese ka përfunduar, sepse rekomandimet e tij janë zbatuar ose ai ka ndërmarrë masa sipas paragrafit 1, atëhere rasti konsiderohet i mbyllur.

Rregulla 21

Publikimi i raporteve dhe rekomandimeve

1. Ombudspersoni do ti publikojë raportet e çështjeve e poashtu ti ruaj atoqë ai i konsideron si informata konfidenciale, ose kur ankuesi ka kërkuar që identiteti i tij dhe rrethanat e ankesës nuk lejohen të zbulohen.
2. Të gjitha raportet do të jenë të mundshme në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe dhe gjuhë tjetër nese Ombudspersoni vëndos ashtu.

Rregulla 22**Raportet Speciale dhe Vjetore**

1. Ombudspersoni do t'ja paraqesë raportin vjetor Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm duke mbuluar të gjitha aktivitetet për një vit kalendarik të filluar prej 30 qershorit.
2. Raporti vjetor do ti paraqitet Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm jo më vonë së 30 nëntori.
3. Ombudspersoni mund ta lëshoj një raport special kur ai mendon që është koha e duhur.
4. Ombudspersoni do ti bëj publike raportet.
5. Raportet speciale dhe vjetore do të jenë të mundshme në gjuhën angleze, shqipe, serbe dhe ndonjë gjuhë tjetër nese Ombudspersoni vendos.

Rregulla 23**Gjuhët**

1. Rregullat e Procedurës janë të publikuara në gjuhën anglezë, shqipe dhe serbe. Verzioni autentikë duhet të jetë në gjuhën angleze.
2. Rregullat e Procedurës ose çdo lloj ndryshimi në to do të përkthehet në çdo gjuhë tjetër që përdoret mbrenda kufijve të Kosovës, nëse Ombudspersoni e sheh të nevojshme.

Rregulla 24**Ndryshimi i Rregullave të Procedurës**

Ombudspersoni mund në çdo kohë të ndryshojë Rregullat e Procedurës duke u konsultuar më zëvendesit e Ombudspersonit.

Rregulla 25**Përcjellja e Rregullave Procedurale dhe Amandamentet Plotësuese**

Rregullat Procedurale dhe çdo amandament do ti dërgohet Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm, Kryesuesit të OSBE-së të Misionit në Kosovë, e poashtu edhe institusioneve tjera relevante lokale.

Rregullat Procedurale do të publikohen.

Rregulla 26**Hyrja në fuqi**

Rregullat e Procedurës do të hyjnë në fuqi më 21 nëntor 2000.

E miratuar më 20 nëntor 2000 dhe e përcjellur me konsultime me zëvendesit e Ombudspersonit.

Marek Antoni Nowicki
Ombudspersoni